

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-43979
Më 25.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Shqipëri dhe pagesës së mëditjeve për Sherife Çengajt, zyrtare komunale, kryetari i Komunës, më 25 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Sherife Çengajt, zyrtare komunale, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë dyditore që organizohet në kuadër të projektit “Iniciativa e marketingut rajonal lindor dhe jugor të Kosovës”. Punëtoria do të organizohet nga data 28 tetor deri me 30 tetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 25.10.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit me shkrim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit dhe ujësjellësit në lagjen Nënkalaja, mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 24.10.2013, për lejimin e ndërtimit të kanalizimit dhe ujësjellësit në lagjen Nënkalaja në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 23.10.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të disa rrugëve lokale, me participim, mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 23.10.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të disa rrugëve lokale, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës "Skender Latifi-II",
2. Rrugës në lagjen e Dragomanit-Kurillë ,
3. Rrugës lokale në fshatin Vlashnje-rruga e ngushtë, dhe
4. Rrugëve lokale në fshatin Hoqë e Qytetit-II.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-38300
Më 23.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, për lejimin e punimeve shtesë dhe lejimin e mjeteve shtesë për projektin “Ndërtimi i objektit të Gjendjes Civile në fshatin Zym”, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

MIRATOHET propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 23.10.2013 për lejimin e punimeve shtesë dhe lejimin e mjeteve shtesë për projektin “Ndërtimi i objektit të Gjendjes Civile në fshatin Zym”, kështu që për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen punimet shtesë dhe mjete shtesë në lartësi prej 2963.00 €.

Neni 2

Pagesa e shumës së lejuar nga neni 1 i këtij Vendimi do t'i bëhet, përfutjesit të kontratës nr. pro. 622-12-156-521.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows the official seal of the Municipality of Prizren, Kosovo, with the name of the Mayor, Prof. dr. Ramadan Muja, and his handwritten signature over it.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtarisht
Më 23.10.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin e rekrutimit të disa mjekëve për kryerje të shërbimeve të veçanta për shëndetësinë primare në komunën e Prizrenit, për kohë të caktuar, mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e rekrutimit të 7 mjekëve për kryerje të shërbimeve (nevojave) të veçanta për shëndetësinë primare në komunën e Prizrenit, për kohë të caktuar, kështu që, lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për rekrutimin e 7 mjekëve për kryerjen e shërbimeve të lartcekura.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Shëndetësisë, Zyra e Personelit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-40648
Më 30.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për AAKV "Emin Duraku" nga Zhuri, kryetari i Komunës më 30 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 29.10.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për AAKV "Emin Duraku" nga Zhuri, me qëllim të pjesëmarrjes në koncertin që organizohet me rastin e shënimit të 101 vjetorit të Pavarësisë, në Kantonin e Neuchatel-it të Zvicrës, kështu që, në emër të përkrahjes së pjesshme financiare, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, AAKV "Emin Duraku" si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 31.10.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit me shkrim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit në fshatin Lubizhdë e Qytetit, mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 31.10.2013, për lejimin e ndërtimit të sistemit të ujësjellësit në fshatin Lubizhdë e Qytetit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-41307
Më 31.10.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e mjeteve financiare për shtrimin e një dreke për pjesëmarrësit e grupit punues ndërkomunal për komunat Shterpc, Prizren dhe Ferizaj, kryetari i Komunës, më 31 tetor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e organizimit të një takimi të Grupit Punues Ndërkomunal për komunat Shterpc, Prizren dhe Ferizaj dhe për lejimin e mjeteve financiare për shtrimin e një dreke për pjesëmarrësit e këtij grupi punues, që do të organizohen në Prizren, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 230 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4,

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 6.11.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.11.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit dhe rregullimin e rrethojave të stadiumit në Prizren, mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e hartimit të projektit të rregullimit të rrethojave të stadiumit në Prizren dhe rregullimit të këtyre rrethojave pas hartimit të projektit përkatës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 6.11.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.11.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me kompjuter me pajisje përcjellëse për nevojat e kësaj drejtorie, dhe mori këtë

KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave për lejimin e furnizimit me 6 kompjuter me pajisje përcjellëse për nevojat e kësaj drejtorie, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Mjetet lejohen prej pozicioneve përkatëse të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, , Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 6.11.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.11.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrethojave standarde metalike të oazave të gjelbëruara, dhe mori këtë


KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të rrethojave standarde metalike të oazave të gjelbëruara në lagjen Bazhdarhane, etj, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-43732
Më 6.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për formimin e Komisionit komunal për vlerësimin e dëmit me rastin e prerjes së drunjve te Stacioni i autobusëve në Prizren, kryetari i Komunës, me 6 nëntor 2013, mori këtë

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara me rastin e prerjes dhe krasitjes së drunjve pa leje përkatëse, te Stacioni i autobusëve në Prizren. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Izet Osmani, kryesues
- b. Galip Belallari, dhe
- c. Muhamet Bajrami.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë: të bëjë një vlerësim real dhe profesional lidhur me dëmet e shkaktuara me rastin e prerjes dhe krasitjes së drunjve pa leje të organeve përkatëse, te Stacioni i autobusëve në Prizren, dhe pas këtij vlerësimi të japë një raport me shkrim me rekomandime konkrete lidhur me marrjen e masave përkatëse. Komisioni mund të marrë edhe veprime të tjera konform ligjit lidhur me këtë rast.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-44998
Më 11.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Sektorit të Gjendjes Civile, për lejimin e mjeteve për furnizim me certifikata të gjendjes civile për vitin 2014, kryetari i Komunës më 11 nëntor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektorit të Gjendjes Civile, për lejimin e furnizimit me certifikata të gjendjes civile për vitin 2014 për nevojat e Sektorit të Gjendjes Civile të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbime.

Neni 3

Furnizimi me certifikata të gjendjes civile do të bëhet sipas kontratës kornizë të nënshkruar në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë dhe operatorit ekonomik i cili është fitues i tenderit përkatës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës- Sektori i Gjendjes Civile, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës- Sektori i Gjendjes Civile, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, MPB, si dhe arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadân Muja